

UDHËZIM
Nr.31, datë 11.10.2010

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E
STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 34 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr.786, datë 29.9.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimi dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e dytë të studimeve, “Master i Shkencave”, për vitin akademik 2010-2011”, të vendimit nr.795, datë 6.10.2010 “Për kuotat e pranimi dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e dytë të studimeve “Master Profesional”, për vitin akademik 2010-2011”,

UDHËZOJ:

1. Pranimin e aplikantëve në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2010-2011, në bazë të përzgjedhjes së bërë nga institucionet publike të arsimit të lartë.

2. Aplikantët fitues përzgjidhen nga institucionet publike të arsimit të lartë në bazë të kriterëve të pranimi të përcaktuara nga institucionet publike të arsimit të lartë dhe të publikuara më parë.

3. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë organizojnë procesin e pranimi dhe të regjistrimit të aplikantëve në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë. Procesi të monitorohet nga rektorati dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

4. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin menjëherë hapjen e procedurës së pranimi të kërkesave për aplikantët që dëshirojnë të vazhdojnë programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë.

5. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë të kryhen nga data 13.10.2010 deri në datën 21.10.2010, prej orës 8.00 deri në orën 18.00 pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore. Për aplikim, kandidati të dorëzojë dosjen individuale, me dokumentet e mëposhtme:

a) Kopje të noterizuar të diplomës së ciklit të parë të studimeve të shoqëruara me listën origjinale të notave;

b) Dokument identifikimi (letërnjoftim ID, pasaportë) dhe fotokopje të noterizuar të tij. Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;

c) 2 fotografi;

d) Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 2500 lekësh.

6. Pranë njësive kryesore përgjegjëse të institucioneve publike të arsimit të lartë për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë të ngrihen komisione *ad-hoc* sipas fushave përkatëse, për përzgjedhjen e aplikantëve fitues në përputhje me kriteret e pranimi të vendosura dhe të shpallura publikisht nga këto institucione.

7. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, brenda orës 16:00 të datës 26.10.2010, të ndarë sipas programeve të studimit përkatëse, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara me vendimin nr.786, datë 29.9.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimi në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave”, me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për programet e studimit të miratuara për vitin akademik 2010-2011” dhe vendimin nr.795, datë 6.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimi dhe tarifat e

shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e dytë të studimeve “Master Profesional”, për vitin akademik 2010-2011”.

8. Regjistrimi i aplikantëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet nga data 27.10.2010 deri në datën 30.10.2010 prej orës 8:00 deri në orën 18:00 pranë sekretarive mësimore të njëjësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë. Dokumentet e aplikantëve jofitues t’u kthehen personave kundrejt kërkesës. Për regjistrimin kandidati duhet të paraqitet personalisht pranë sekretarive mësimore dhe të dorëzojë dokument origjinal: dëftesën e pjekurisë (në mungesë, lista e notave me fotografi, e nënshkruar nga drejtori i shkollës e nga drejtori i drejtorisë arsimore rajonale/zyrës arsimore, ose dokument i lëshuar nga Arkivi i Shtetit me notat përkatëse).

9. Pas mbylljes së procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listat përfundimtare origjinale me regjistrimet e kryera brenda datës 10.11.2010, në bazë të udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.

10. Institucionet publike të arsimit të lartë, duke filluar nga data 12.10.2009, të shpallin në vende të dukshme datat dhe oraret e veprimeve të konkurrit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë.

11. Këto njoftime të bëhen publike edhe në median e shkruar e elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

12. Ngarkohen sekretari i përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, si edhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj